

JVA Weiterstadt – Vizitë me video

I nderuar zonjë / I nderuar zotëri,

Ju keni marrë këtë mesazh me linkun e hyrjes për një vizitë me video me të burgosurin e përmendur më sipër në burgun JVA Weiterstadt, pasi është caktuar një takim vizite me video nga ju ose nga i burgosuri. Ju lutemi, kini parasysh edhe udhëzimet e mëposhtme.

Mos dërgoni përgjigje në këtë adresë emaili – ato nuk do të përpunohen.

Për të siguruar një zhvillim të rregullt të vizitës, ju lutemi kushtoni vëmendje pikave të mëposhtme:

Vizita me video zhvillohet përmes një programi me burim të hapur, të cilit mund t'i qaseni përmes çdo shfletuesi të zakonshëm interneti.

Ju lutemi lidheni pak minuta para fillimit të orarit të planifikuar dhe prisni që JVA Weiterstadt të nisë takimin. Ju lutemi për durim – vizita zgjat një orë.

Para fillimit të vizitës, punonjësit e burgut do të kontrollojnë dokumentet e nevojshme. Ju lutemi mbani me vete dokument identifikimi të vlefshëm për të gjithë pjesëmarrësit!

Patentat, kartat e sigurimeve shëndetësore, certifikatat e lindjes etj. nuk pranohen!

Pa dokument identifikimi, vizita nuk mund të zhvillohet!

Në rast se ka masa të urdhëruara nga gjykata sipas nenit §119 të Kodit Penal Gjerman (StPO), fletëvizita nga gjykata ose prokuroria duhet të paraqitet në origjinal, me nënshkrim dhe vulë zyrtare. Para vizitës së parë me video, ky dokument duhet të paraqitet fizikisht në JVA Weiterstadt gjatë një vizite me praninë tuaj. Vetëm atëherë lejohen vizitat me video.

Rregullat gjatë vizitës me video:

- Vizita duhet të zhvillohet në ambiente të mbyllura dhe jo publike.
- Lejohen vetëm personat e autorizuar për vizitë.
- Gjatë vizitës nuk lejohen fotografimi apo incizimi i videos.
- Nuk lejohet të tregohen letra, fotografi apo objekte të tjera në kamera.
- Në sfond nuk duhet të ketë transmetime televizive, audio, apo rrjedha online si YouTube apo Spotify.

Vizita ndalohet ose ndërpritet nëse:

- Rrezikohet siguria dhe rendi i JVA Weiterstadt.
- Vizitori ndryshohet ose shtohet një tjetër person.
- I burgosuri apo vizitori zbathen ose zhvishen.
- Realizohen pamje ose incizime gjatë vizitës.

Justizvollzugsanstalt Weiterstadt

Besuchsterminierung
Vor den Löserbecken 4



64331 Weiterstadt

Hinweise zur Verarbeitung personenbezogener Daten im Rahmen der Europäischen Datenschutzgrundverordnung (DSGVO) bzw. der Richtlinie (EU) 2016/680 erhalten Sie auf der Internetseite der Dienststelle. <https://justizvollzug.hessen.de/datenschutz>

Auf Wunsch werden diese Informationen auch in Papierform zur Verfügung gestellt.



Bitte denken Sie an die Umwelt, bevor Sie diese E-Mail ausdrucken.

Please consider the environment before printing this e-Mail.

Übersetzt von Kollege Aliji